



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.1049/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić kryesuese, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e Edona Caraku, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1049/2021, paraqitur nga Edona Caraku, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Qendrat e Votimit QV 2107B,, QV 2106B, QV 2101X dhe në vendvotimet VV 2107B/03R, VV 2107B/04D, VV 2124B/02D, në Komunën e Skenderajt

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga Edona Caraku, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj me të cilën pretendon se në Qendrat e Votimit QV 2107B,, QV 2106B, QV 2101X dhe në vendvotimet VV 2107B/03R, VV 2107B/04D, VV 2124B/02D ka pasur keqpërdorime ashtu që votat e saj i janë dhënë dikujt tjetër ashtu që mungojnë votat e votuesve të saj. Në mbështetje të pretendimeve të saj nuk ka paraqitur asnjë dëshmi si provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Edona Caraku, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, me të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Qendrat e Votimit QV 2107B,, QV 2106B, QV 2101X dhe në vendvotimet VV 2107B/03R, VV 2107B/04D, VV 2124B/02D, në Komunën e Skenderajt është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e tij nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara andaj këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Kështu qe Paneli vlerësoi se apeli nuk është i bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1049/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuese e Panelit

Milena Derić

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi